



SHOQATA KOMBËTARE E GRUAS PROFESIONISTE, AFARISTE DHE ZEJTARE

GRATE NE INOVACION DHE KRIJIMTARI

Forca e ndryshimit

Editorial

Më 27 prill 2018, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Pronësisë Intellektuale, u mbajt në hotel Tirana, Konferenca Kombëtare **"Forca e ndryshimit: Gratë në Inovacion dhe Krijimtari"**. Ky aktivitet u organizua nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) me rastin e 25 vjetorit të themelimit të DPPI: Shoqata e Gruas Profesioniste, e cila është krijuar që prej vitit 1993 fillimisht si "Zyra e Patentave". Gjatë kësaj konference u prezantuan arritjet në rrugën e vështirë 25 vjeçare të DPPI-së, por theksi u vu në forcën e gruas sipërmarrëse në drejtim të

inovacionit, ku një kontribut të rëndësishëm ka dhënë edhe Shoqata Kombëtare e Gruas Profesioniste, Afariste dhe Zejtare, me presidente znj. Flutura Xhabija, e cila gjatë këtyre viteve ka bërë të mundur që disa anëtare të saj të regjistrojnë si patentë produktet e tyre në fushën e prodhimit të qilimave dhe të qëndisjes.



Në këtë konferencë znj. Blerina Xhabija prezantoi 3 patentat e saj të regjistruara në Itali.

Suksese!

Buletin Informativ

Prill 2018

NË KËTË NUMËR

Takim me Diasporën në Tiranë dhe Prishtinë

Më 3-5 prill 2018, u mbajtën në Tiranë dhe në Prishtinë takimet me Diasporën. Faqe 4



Tryezë e Rrumbullakët për përgatitjen e Shoqërisë Civile Shqiptare për negociimet për hyrjen në BE

Më datë 12 prill 2018, u mbajt në Tiranë takimi për rëndësinë e përfshirjes së shoqërisë civile në negociime. Faqe 5



Forum biznesi Shqipëri-Libi

SHGPAZ u përfaqësua me disa anëtare.

Më 11 prill 2018 u mbajt në Tiranë Forumi i biznesit Shqipëri-Libi. Biznese nga Libia po shohin mundësi investimi në vendin tonë, kryesisht në fusha si bujqësia dhe blegtoria, por dhe të importojnë produkte të ndryshme ushqimore në vendin e tyre, si një treg me potencial të lartë. Një forum biznesi i mbajtur për herë të parë në vendin tonë, ka bërë bashkë sipërmarrës të dy shteteve, ku përmes takimeve, do të hapin dyert për mundësinë e bashkëpunimit tregtar dhe investimeve të ndërsjella. Aktualisht shkëmbimet tregtare me Libinë janë në nivele të ulëta dhe gjetja e tregjeve të reja për produktet shqiptare është e nevojshme.



Konkursi IDEA për plane biznesi



Në kuadër të Konkur-sit **IDEA** për plane biznesi, gjatë muajit prill janë organizuar 2 start-ups weekend, me trainime me aplikantët e përzgjedhur në qytete të ndryshme si Tiranë, Shkodër, Elbasan, Durrës etj. Ky projekt mbështet të rinjtë që kanë një ide biznesi ose drejtojnë një biznes prej më pak se 3 vjet.

Konkursi IDEA ofron një paketë të plotë mbështetjeje nëpërmjet seancave tërheqëse të trajnimit, coaching/këshillim, mentorim dhe fituesve do t'u ofrohet grant.

Linku i IDEA në facebook:

www.facebook.com/ideaalbania

Bankat dhe biznesi

Ndryshimet në kredinë për individë


Gjatë periudhës së rritjes së shpejtë të kredisë 2003-2008, bankat rritën me shpejtësi kredinë për individë. Veçanërisht gjatë kësaj periudhë ato u fokusuan në prezantimin e produkteve me kushte atraktive të kreditimit për blerjen e banesave, të cilat dominuan dhe rritjen e portofolit të individëve në këtë periudhë. Ofertat e

bankave u shoqëruan nga një kërkesë e lartë e individëve për financim në përgjigje të nevojave për përmirësimin e kushteve të banimit dhe

çmimeve të banesave në rritje. Në fund të vitit 2007, segmenti i kredisë për individë shënoi peshën më të lartë historike në portofol, me 37.2% të kredisë totale.

Menjëherë mbas krizës financiare të vitit 2008, kredia për individë u tkurr me shpejtësi dhe pesha e saj në totalin e kredisë ka qenë përgjithësisht në rënie. Këto zhvillime reflektojnë si shtrëngimin e ndjeshëm të standardeve të kreditimit ashtu edhe hezitimin e individëve për të kërkuar kredi. Kjo ecuri duket sikur ka ndryshuar që prej vitit 2015 dhe në vazhdim. Në tre vitet e fundit, normat e rritjes së kredisë për individë janë

vendosur në një trajektore rritëse duke shënuar mesatarisht rreth 5%. Në fund të vitit 2017, kredia për individë shënoi rritje në 33.2% të kredisë për sektorin privat. Zhvillimet pozitive të portofolit të kredisë së individëve në këtë periudhë janë mbështetur më së shumti nga rritja e shpejtë e kredisë konsumatore, kurse kredia për banesa shfaqet me



ritme rritjeje të përmbajtura. Përmirësimi i konsumit privat në ekonomi, së bashku me rritjen e besimit dhe përmirësimet e tregut të punës kanë çuar në një kërkesë më të lartë për kredi nga individët. Zhvillimet në portofolin e kredisë për individë janë përkrahur herë pas here edhe nga iniciativat qeveritare për formalizimin e tregut të punës si dhe afrimin e individëve për të marrë pagat në banka. Nga ana tjetër bankat kanë lehtësuar më tej standardet e kreditimit për individët, për t'ju përgjigjur si konkurrencës së shtuar mes tyre ashtu edhe hapësirave për ndërmjetësim që ky segment ofron. Kreditë me probleme në

këtë segment janë shumë më të ulëta se sa ato për biznese dhe për rrjedhojë ofrojnë për banka një segment që akoma ka nevojë për financim.

Një tjetër ndryshim i rëndësishëm në portofolin e bankave është edhe balancimi sipas monedhës i kredisë. Paralelisht, bankat kanë zhvendosur aktivitetin kreditues drejt kreditimit në monedhën vendase. Në 5 vitet e fundit rritja e kredisë në lekë prej mesatarisht 6.5% ka shërbyer për të balancuar tkurrjen e kredisë në valutë, dhe ka mundësuar rritjen e kredisë për

sektorin privat. Këto zhvillime mbas krizës kanë ndikuar në zhvendosjen e portofolit të kredisë drejt një strukture më të ekuilibruar. Kredia në lekë për sektorin privat në fund të

vitit 2017 përbënte 45.2% të portofolit krahasuar me 29% që zinte në vitin 2007. Nën - segmente të portofolit të kredisë që kanë shfaqur zhvendosje më të madhe drejt lekut kanë qenë kredia afatgjatë e lidhur me kredinë për investime si për bizneset ashtu dhe individët. Ulja e normave të interesit në lekë dhe për rrjedhojë ngushtimi i diferencialit të normave interesit me ato në euro së bashku me ndërgjegjësimin e agentëve ekonomikë për rrezikun e kursi të këmbimit kanë qenë faktorët kryesorë që kanë nxitur këtë zhvendosje.

Deklarimi i TVSH për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë në vit

Që nga 1 prill 2018 hyri në fuqi TVSH-ja për bizneset e vogla me xhiro vjetore **2-5 milion lekë/vit**.

Mjaft debate ekonomiko-politike janë mbajtur gjatë kësaj periudhe për të treguar e argumentuar efektin e kësaj politike të re të qeverisë, por si konkluzion dhe pa asnjë dyshim që kjo do të jetë një barrë tatimore shtesë për këtë grup biznesesh.

Gjithashtu kjo politikë e re e qeverisë nuk është sipas rekomandimeve të BE-së dhe FMN-së, e cila ka kërkuar që për të nxitur vetëpunësimin dhe krijimin e bizneseve të reja e familjare, praku i xhiros vjetore për bizneset për të hyrë në

skemën e TVSH-së të rritet si dhe të thjeshtohet skema e pagesës së tatimeve.

Padyshim që ky vendim i ri rëndon më tej kostot e biznesit



tuaj, por kujdes se përpos tatimit mbi vlerën e shtuar edhe me gjoba të ndryshme. Prandaj nëse nuk keni aftësi personalisht për të

mbajtur evidencat e kërkuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, angazhoni ndonjë pjesëtar të familjes për t'u informuar për procedurat e reja, apo angazhoni ndonjë financier për të mbajtur llogaritë ekonomike.

Por gjithashtu në skemën e TVSH-së tashmë janë përfshirë të gjithë bizneset e profesioneve të lira si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i tyre, është zero.

Kujdes Sipërmarrës së biznesit të vogël që keni hyrë në skemën e pagesës së TVSH me afatet e deklarimit të formularëve TVSH!

Takim me Diasporën në Tiranë dhe Prishtinë



Më datë 3 prill 2018 u mbajt në Tiranë takimi me Diasporën, organizuar nga konsullja e nderit Anduena Stephan, për fushat e bashkepunimit në sektorë të rëndësishëm si: arsimi, mjekësia, IT, formim profesional, biznesi etj.

Më data 4-5 prill 2018 u mbajt në Prishtinë takimi me diasporën për të diskutuar më tej për një bashkëpunim të frytshëm e të qëndrueshëm midis intelektualëve shqiptar dhe ata të diasporës për të kontribuar në zhvillimin e vendit.

Rëndësia e mbrojtjes së Pronësisë Industriale nga sipërmarrja shqiptare

Nga Albana Laknori

Historia e DHTI për mbrojtjen e Pronësisë Intellektuale (IP)

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë është institucioni më i vjetër privat i Pronësisë Intellektuale në Shqipëri dhe një nga më të njohurat në Evropë, me ekspertizë në mbrojtjen e patentave të shpikjeve, markave tregtare, si dhe të drejtat e autorit. Markat e para kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe patentat e shpikjeve të para janë lëshuar nga DHTI Tirana e cila ka partnerë në 15 qytete evropiane në 15 vende të tjera të botës: Torino, Milano, Romë, Zvicër, Spanjë, Gjermani, Turqi, Çeki, Greqi, SHBA. DHTI u siguron bizneseve konsulencën më të gjerë të mundshme të drejtave të IP-ve - që nga konceptimi fillestar deri te mbrojtja dhe vendosja e të drejtave tuaja të IP në Gjykatë. Gjatë viteve DHTI ka menaxhuar patentat dhe markat tregtare për shumë klientë të çdo madhësie, sektori dhe zone gjeografike, pra ka një eksperiencë e përvojë me pothuajse çdo lloj çështjesh IP që mund të dalin.

Mesazh

"E bëjmë mirë, nëse e bëjmë së bashku". Përkrahja dhe shtysa për të bërë mbrojtjen e të drejtave të IP, dhe zbatimi i saj ende është i fragmentuar, megjithë disa zhvillime inkurajuese. Për ta bërë këtë është e nevojshme koordinimi i zyrave të IPR në nivel evropian dhe kombëtar.



"Të kuptojmë nevojat e SME-ve".

Problemet e IP-së për SME-të, disa herë anashkalohen ose nënvlerësohen nga vetë bizneset, e më pas kur ato shkelen, edhe nga policia dhe autoritetet doganore, si dhe nga gjykatat.

"T'i ndihmojmë SME që të përgatisin portofolin tyre të IP".

Zbatimi efektiv i mbrojtjes së IP mbetet në menaxhimin e duhur të IP. Nuk mund të zbatohen të drejtat e IP, që nuk janë të dokumentuara qartë dhe, aty ku është e përshtatshme, të regjistrohen.

"Te bëjmë zbatimin e IP një pjesë të imazhit të madh të inovacionit".

Nuk ka sesi të bëhet inkurajimi i bizneseve për risitë që sjellin, nëse nuk mund të sigurohen përfitimet. Menaxhimi i IP dhe siguri i zbatimit duhet të shihet si pjesë e ciklit të inovacionit dhe të mbështeten dhe të financohen si të tilla, nëpërmjet programeve të BE-së dhe R & D kombëtare si dhe mbështetjes së inovacionit.

"Ta bëjmë mbrojtjen e IP cilësore".

Si fillim, një shërbim i

përbashkët i Pronësisë Intellektuale duhet të zhvillohet kudo në vend të shërbimeve të ndryshme për secilin lloj të IPR që ende janë normë në shumicën e vendeve të evropiane. Ekziston nevoja për koordinim më të mirë ndërmjet specialistëve dhe agjencive mbështetëse të SME-ve, siç janë dhomat e tregtisë në gjithë Shqipërinë.

"Ta çojmë IP pranë konsumatorit". Një përpjekje e vazhdueshme nevojitet për t'i sjellë konsumatorëve në shtëpi, se çfarë ndodh në rastin e përdorimit të mallrave të fallsifikuara ose pirate.

Ndërgjegjësimi më i madh për dëmet dhe rreziqet potenciale mund të eliminojë nevojën për një zbatim sa më të madh.

"Të mësojmë se çfarë ka të mirë rreth e rrotull". Ka shumë shembuj të praktikës së mirë, nga skemat që merren me pika të nxehta të tavolinave të fallsifikimit të mundshëm të mallrave, në ambasadat dhe konsullatat në vendet jashtë Evropës.

Të zgjidhim problemin duke paguar për të". Kostoja e lartë e zbatimit të të drejtave të IP, paraqet vështirësi të mëdha për SME-të; ato nuk presin para në dorë, por ka shumë që mund të bëhet për t'i ndihmuar, duke filluar nga nxitja e skemave të siguruara për inkurajimin e organizatave që merren me luftën kundër piraterisë dhe për të zgjeruar bazën e aktiviteteve të tyre në këtë pikëpamje.

Tregtia e lirë në Ballkan, Plani koordinohet nga CEFTA. Merren masat e para

nga **Violeta Shqalsi**

Plani për krijimin e një Zone Ekonomike Rajonale në Ballkan ka filluar të konkretizohet dhe tashmë janë duke u marrë hapat e parë. Sipas Drejtoreshës së Përgjithshme të Doganave, **Belinda Ikonimi**, koordinimi dhe monitorimi i disa fushave të caktuara të këtij plani do të bëhet nga CEFTA, organizata e marrëveshjes tregtare që përfshin Europën Qendrore. Protokolli Shtesë 5 i CEFTA, i cili përfshin një numër veprimesh për përsheptimin e procedurave ndërkufitare, tashmë është miratuar nga parlamenti.

“Objektiva parësore për Administratën tonë në kuadër të këtij Protokolli janë, thjeshtimi i inspektimeve, reduktimi i formaliteteve të eksportit, shkëmbimi elektronik i të dhënave, njohja reciproke e testeve laboratorike dhe AEO-ve, zbatimi efektiv i kontrollit të riskut dhe bashkëpunimi me agjencitë e tjera që veprojnë në kufi”, tha Ikonimi, gjatë një workshopi mbi mbështetjen për lehtësimin e tregtisë mes palëve të CEFTA.

Një nga masat që do të merren është njohja reciproke e Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar (AEO), pra prodhuesit, importuesit, eksportuesit, etj. që fitojnë këtë status.

Administrata Doganore Shqiptare ka krijuar një strukturë të posaçme për AEO-të dhe lehtësirat doganore. Në këtë kuadër ka nisur një fushatë

sensibilizimi për nxitjen e biznesit për të aplikuar dhe përfituar nga lehtësirat doganore. “Prioritet i Qeverisë Shqiptare është krijimi i një klime të favorshme për biznesin, të cilin e konsideron motor të zhvillimit ekonomik të vendit. Kështu që njohja reciproke e AEO-ve midis vendeve anëtare të CEFTA-s padyshim që sjell një lehtësi të madhe për Operatorët që do të përfitojnë këtë status në të gjithë rajonin”, u shpreh Drejtoresha e Përgjithshme e Doganave.

Çfarë është një OEA?

Operatori Ekonomik i Autorizuar: është një status i lëshuar për “tregtarët me besueshmëri” të cilët mund të përfitojnë nga shumë thjeshtime doganore. Sipas Kodit Doganor Shqiptar, janë dy lloje statusi për OEA që mund të lëshohen:

“**OEA-D** për thjeshtime doganore: nënkupton një operator ekonomik të autorizuar për thjeshtime doganore.

“**OEA-S** për sigurinë dhe mbrojtjen: nënkupton një operator ekonomik të autorizuar për lehtësira në kontrolle doganore.

Nëse një OEA kërkon të përfitojë një thjeshtim/ regjim, dogana nuk shqyrton kushtet apo kriteret.

Administrata Doganore Shqiptare ka vënë në zbatim statusin OEA sipas standardeve ndërkombëtare dhe për këtë qëllim është nënshkruar një Marrëveshje për Njohje të

Përbashkët me shtetet e CEFTA-s me kusht bazën ligjore dhe zbatimin në përputhje me BE-në, ku palët në CEFTA informojnë njëra-tjetrën në lidhje me identitetin e OEA-ve.

Përfitimet e statusit të OEA-ve

a) Një trajtim më i favorshëm në lidhje me vlerësimin e riskut dhe kontrollet:

Më pak kontrolle fizike dhe të dokumentacionit në krahasim me operatorët ekonomikë të tjerë; Trajtim prioritar dhe njoftim prioritar në rast seleksionimi për kontroll doganor; Mundësi për të kërkuar hapësira specifike përveç zyrave doganore për kontrollet e doganës.

b) Një akses i thjeshtuar apo ekskluziv për disa thjeshtime doganore:

Reduktim i nivelit të garancisë apo përjashtim nga garancia; Thjeshtime në transit; Thjeshtime në vlerë; Autorizim për deklarata të thjeshtuara etj.

c) Marrëveshje për njohje të përbashkët me shtete të tjera.

Kriteret e OEA-ve

Sipas llojit të autorizimit të kërkuar, aplikuesi duhet të përmbushë disa kriteret: Të mos ketë kryer shkelje të rënda apo të përsëritura të legjisllacionit doganor dhe rregullave tatimore; Të ketë një sistem menaxhimi tregtar, dhe nëse është e nevojshme regjistra transporti, të cilat lejojnë kryerjen e kontrolleve doganore të përshtatshme; Të ketë aftësi të mira paguese. OEA ka hyrë në fuqi në BE në Janar 2008.

FAKTE

26.8%

Biznese aktive të drejtuar/pronare gra, për vitin 2016 në Shqipëri rezultojnë 26.8% me një rënie me 4.5 pikë % në krahasim me vitin 2015 ku përbënin 31.3%. (INSTAT)




3.2%

Kredia për vitin 2017 rezulton me një rritje modeste me vetëm 3.2% krahasuar me një vit më parë dhe zë 36,5% ndaj PPB, me një ulje prej 1 pikë përqindje krahasuar me 2016. (Banka e SHqipërisë)



Debat televiziv më 14 prill 2018

Në scan TV në emisionin Bardh a Zi në një debat televiziv presidentja e SHGPAZ znj.Flutura Xhabija jep opinionin e vet për ndikimin e politikës në zhvillimin e gruas sipërmarrëse dhe kontributin që jep në zhvillimin ekonomik të vendit. Mesazhi i saj për të gjithë politikanët e të gjitha ngjyrave është që punoni për të mirën e vendit dhe për të ndërmarrë politika për të nxitur Gratë në biznes, për fuqizimin e mëtejshëm të gruas.



Viti kulturor Austri-Shqipëri

“Kandelat e Ringjalljes”

Në kuadër të vitit kulturor Austri-Shqipëri, dhe me rastin e festave të Pashkëve, më datë 9 prill 2018, në Tiranë u zhvillua Koncerti “Kandelat e Ringjalljes” me muzikë klasike nga orkestra e harqeve “Virtuozët e Rinj” të dirigjuar nga mjeshtri i mash Zhani Ciko. Koncert që rezatonte paqe e mirësi ashtu sikundër edhe mesazhi i vetë pashkëve!

Gëzuar!



Gruaja dhe shëndeti

Mbulimi universal i kujdesit shëndetësor, më pak se synimi i zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së

Materiale të përpunuara nga **Arlinda Demeti**

Muaji prill konsiderohet si muaji për ndërgjegjësimin e popullatës për nevojat e mbulimit të kujdesit shëndetësor nga qeveria.

Sipas një studimi të kryer nga Instituti për Matjen dhe Vlerësimin e Shëndetit (IHME) në Universitetin e Uashingtonit dhe të botuar në prill 2018 në revistën mjekësore ndërkombëtare "The Lancet", konstatohet se:

Rreth 5,4 miliardë njerëz në botë pritet të mbulohen nën një formë të kujdesit universal shëndetësor (UHC) deri në vitin 2030, nga 4.3 miliardë në vitin 2015, por shumë më poshtë objektivit të synuar në synimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Studimi gjen se, ndërkohë që shpenzimet shëndetësore pritet të rriten gjatë dekadave të ardhshme, ka gjasa


të vazhdojë kufizimin e përpjekjeve për të arritur mbulimin shëndetësor universal.

Sipas studimit është identifikuar një korrelacion që një rritje prej 10 për qind e shpenzimeve shëndetësore qeveritare, shpenzimet private të parapaguara dhe ndihmat zhvillimore për shëndetin, sjell një rritje prej 1.4 për qind në mbulimin shëndetësor universal.

Për më tepër, studimi gjen se shpenzimet globale shëndetësore pritet të dyfishohen gjatë 20 viteve të ardhshme, nga 10 trilionë dollarë në vitin 2015 në 20 trilionë dollarë në vitin 2040; shpenzimet për person pritet të rriten më së shumti në vendet me të ardhura mesatare.

Është vlerësuar se shpenzimet shëndetësore për person në 2040

do të shkojnë nga një nivel i ulët prej **40 \$** në Republikën e Afrikës Qendrore në **16,362 \$** në Shtetet e Bashkuara. Në mesin e katër grupeve të të ardhurave, ndarja është **8,666 \$** për banor për vendet me të ardhura të larta, **2,670 \$** për vendet me të ardhura të mesme, **714 \$** për vendet me të ardhura të mesme dhe




190 \$ për vendet me të ardhura të ulëta në 2040.

Gjetjet e tjera përfshijnë:

- Vendet me të ardhura të larta parashikohen të shpenzojnë në shëndetësi për person 45 herë më shumë se sa vendet me të ardhura të ulëta në vitin 2040.
- Shpenzimet për person janë parashikuar të rriten në 177 nga 188 vende deri në vitin 2040.
- Globalisht, shpenzimet jashtë xhepit (jo qeveritare) vlerësohen të rriten më shpejt, ndonëse qeveritë pritet të mbeten burimi më i madh i financimit në 2040, me 61.3% të shpenzimeve totale shëndetësore.

Në **Shqipëri** edhe se propagandohet se shërbimi shëndetësor është falas për të gjithë popullatën, realiteti tregon se ky shërbim shëndetësor nuk është cilësor, dhe se më shumë se gjysma e shpenzimeve shëndetësore mbulohen nga xhepat e qytetarëve.

Edhe pse kanë filluar disa skema të kontrollit dhe parandalimit të sëmundshmërisë në vend, mbetet shumë për të bërë.



Dita e Solidaritetit midis Brezave

Më 30 prill 2018, me rastin e Ditës Europiane të Solidaritetit midis Brezave, në ambjentet e CoDe Albania u mbajt takimi "Gjeneratat së Bashku".

Një takim mjaft interesant i organizuar nga ASAG, ku referuese ishin Mira Pirdeni, Flutura Xhabija etj.



Tryezë e Rrumbullakët për përgatitjen e Shoqërisë Civile Shqiptare për negocimet për hyrjen në BE

Më 12 prill 2018, në ambjentet e Hotel Rogner, u mbajt tryeza e rrumbullakët për përgatitjen e shoqërisë civile shqiptare për negocimet për hyrjen në BE. Gjatë muajit prill Shqipëria morri përgjigjen pozitive për propozimin që Komisioni European i paraqiti Këshillit të Europës për hapjen e negocimeve për hyrjen në BE të Shqipërisë. Ky është një lajm i mirë për të gjithë shqiptarët, që aq shumë e kanë dëshiruar Shqipërinë si pjesë të BE-së. Shpresojmë që ky propozim të miratohet në mbledhjen e qershorit, por ndër kohë Shqipëria duhet të filloj me përgatitjen e grupeve të negocimit për secilin kapitull. Në kë takim u prezantuan eksperiencat e Kroacisë, Malit të

Zi dhe Serbisë për përfshirjen e shoqërisë civile në grupet e negocimit për çdo kapitull. Eksperienca interesante dhe të vlefshme edhe për Shqipërinë. Shpresojmë që institucionet përkatëse do t'i marrin parasysh e do t'i integrojnë në punë e tyre këto eksperiencat.

Suksese!



Buletin Informativ

Prill 2018

Rr.Mujo Ulqinaku,
Pall.Kristian Konstruktion,
kati 1, ap.9 Tirana-Albania
phone/fax:00355 4 2235726
mob.0682763344, 0692572423
info.shgpaz@yahoo.com



Pergatiti
Msc. Flutura XHABIJA &
Redaksia

Kalendari i Panaireve në Poloni Prill-Maj 2018

APRIL	 06-08.04.2018 Animals Days	 12-14.04.2018 ICT Live - IT & Mobile Expo	 12-15.04.2018 ELECTRONICS SHOW - Central European Smart Electronics Show by Saturn	 20-22.04.2018 Good Game	 20-22.04.2018 Warsaw Comic Con
	 12-13.05.2018 Classic Cars Fair and Auction	 18-20.05.2018 Fitness and Strength Sports Fair	 18-20.05.2018 Bio CONTRACTING - Ecological Industry Fair	 24-26.05.2018 Warsaw Food Expo	